



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 23, datë 14.01.2020

PËR

KOMANDIMIN E GJYQTARES Znj{...} NË POZICIONIN E NËPUNËSIT PËRGJEGJËS PËR VLERËSIMIN NË NJËSINË E VLERËSIMIT PROFESIONAL DHE ETIK TË GJYQTARËVE NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 53, 54 pika 5 dhe 6 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 104, datë 05.07.2019 “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtareve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

V E N D O S I:

1. Komandimin e gjyqtares Znj.{...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin ” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve.
2. Periudha e komandimit është 2 (dy) vjet dhe fillon në datë 21.01.2020.
3. Përrjashtimin e menjëhershëm të gjyqtares Znj.{...} nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore me short në gjykatë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR